



Datë: 28.10.2025
Numër Protokolli: 7079 /2025

A.nr.1578/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare Ardita Haxhnikaj - Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1578/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesja V.D- L, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1578/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesja V.D- L.

A r s y e t i m

Ankuesja V.D - L, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuese), me datë 11.08.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 11.08.2025 nën shenjën A.nr.1578/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Ferizajit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.09.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, nuk është përgjigjur deri në marrjen e këtij e këtij vendimi.

70Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj numri i kërkuar gjashtë (6), klasa profesional 1, ma afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesja ka aplikuar në konkursin e lartpërmendur, dhe sipas njoftimi për fazën e verifikimit paraprak e njëjta rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional.

Pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017332, më datë 11.07.2025 Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ka publikuar rezultatet përfundimtare kur rezultojnë 19 kandidatë që kanë marr mbi 70 pikë, ndërsa ankuesija ka arritur të grumbulloje gjithsejtë 74.6 pike të përgjithshme dhe është renditur e nënta ne liste. Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës në njoftimin e lartpërmendur ka publikuar kandidatët fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja B.A, është vlerësuar me gjithsejtë 91 pikë, kandidati i dytë P.J më 90.8 pikë dhe kandidati i tretë A.R me 89.4 pikë, kandidati i katërt XH.L me 85.4 pikë, kandidatja e pestë XH.M me 80.2 pikë, kandidatja e gjashtë XH.Z me 77.8 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kësaj procedure, pretendon se ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore, duke kërkuar që të aprovohet ankesa të anulohet njoftimi për rezultatet përfundimtare respektivisht të anulohet në tersi konkursi.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr. 1372/2025 të datës 27.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN00017332, për Grupin Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Ferizajt.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr. 1372/2025 të datës 27.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN0001332, për pozitën Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Ferizajt, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1578/2025, të datës 11.08.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1578/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses V.D- L;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*